

CHANGES IN THE EDUCATION SYSTEM

Miranda ILAZI

University of Tetova, Faculty of Philology, Albanian Language and Literature

miranda.ilazi@unite.edu.mk

UDC 37.09:37.016

Conference paper

Abstract

The change involves different goals of life; it reaches to touch the most sensitive situation for mankind, and especially the situations that are related to the future of the country. These changes we can say did not need to be accepted, but time speaks differently, because if you fail to take the current step, then you not only have left one step but you will find it difficult to go ahead.

Changes in education should not come up with quick steps, as to decide what changes you want to do in the educational process you will need to analyze and test that change, if it will positively and successfully influence the students and the teaching, then with a foresight we should make the decision that this is going to be a change that will be good for my society, and what is most important this change will develop in the right way our children's wisdom.

Being in a process of following the time, technology and the latest achievements and implementing these in the educational process is not easy, but when you have a clear goal for the future and you want to help properly youth, then you surely have success in improvement.

Key words: *Education, teaching, student, system, methodology.*

Përbledhje

Ndryshimi përfshin caqe të ndryshme të jetës, ai arrin të prek edhe situatat më të ndjeshme për njerëzimin dhe sidomos situata që kanë të bëjnë me të ardhmen e vendit. Këto ndryshime ne mund të themi që nuk do kishte nevojë t'i pranojmë, por koha flet të kundërtën pasi nëse ti nuk arrin të kapësh hapin e tanishëm që të ecësh përpara, atëherë ti jo vetëm që ke lënë pas një hap, por do ta kesh vështirë të hapërosh para. Ndryshime në arsim nuk do të duhet të vijnë me hapa të shpejtë.

Për të vendosur se çfarë ndryshimesh dëshiron të bësh në procesin edukativo-arsimor, do të duhet të analizosh dhe të vësh në provë atë ndryshim nëse ai do të ndikojë pozitivisht dhe me sukses te nxënësit dhe te mësimdhënia. Atëherë me një largpamësi do të duhej të marrim vendimin që po ky do të jetë një ndryshim që do t'i bëjë mirë shoqërisë time, dhe çfarë është më e rëndësishmjë, ky ndryshim do të zhvillojë në rrugë të drejtë mençurinë e fëmijëve tanë.

Të jesh në një proces ndjekës të kohës, teknologjisë dhe të arriturave më të fundit dhe t'i zbatosh këto në procesin arsimor nuk është e lehtë, por kur ke një synim të qartë për të ardhmen dhe do t'u ndihmosh si duhet rinisë, atëherë sigurisht që ke sukses në përmirësim.

Fjalët kyçe: *Arsim, mësimdhënie, nxënës, sistem, metodikë.*

Pse duhet të ndryshojnë shkollat?

Bota po ndryshon gjithnjë e më shpejtë. Njerëzit vazhdimisht flasin se arsimi duhet të ndryshojë që t'u përgjigjet nevojave të shekullit 21. Ndryshimi i përfshinë të gjithë dhe është shumë vështirë të gjenden përgjigje adekuate. Bota në të cilën jetojmë aktualisht është bota me shumë përgjigje dhe mundësi të pakufizuara. Ajo duket “kaotike” (pa rend), andaj është me rëndësi thelbësore t'i kërkojmë mënyrat më të mira që të vijmë deri te qëllimi. Por patjetër duhet të mësohem i jetojmë në atë botë, që të jemi të suksesshëm.¹

Nga vetë zhvillimi fizik i personave kërkohen ndryshime si jetësore ashtu edhe shpirtërore e edhe materiale, themi kështu sepse ndryshimet e viteve kërkojnë që të pasurohesh shpirtërisht me informacione dhe materiale që kërkohen për t'iu përshtatur kohës dhe hapave të mëdha që sjell ajo me ecjen e pandalshme të saj, kjo e njëjtë sigurisht ndodh edhe me proceset tjera që e rrëthojnë njeriun dhe kërkohet që pas çdo zhvillimi kohor të jemi të parapërgatitur për to, së paku të jemi të informuar që të përballemi me reforma dhe risi që sa më lehtë të përshtatemi me stuhitë e kohës që ndikojnë në natyrën e njeriut.

Dhashë këtë sqarim që sa më mirë ta kemi të qartë se edhe ndryshimet e sistemit arsimor janë të lidhura po me proceset e ndryshimit të njeriut dhe kalimit të viteve të tyre pasi diapazoni i njeriut rritet me vetë rritjen e njeriut dhe me kërkuesat për të ditur më tepër. Prandaj ndryshimet e shkollave dhe sistemit arsimor është tepër i nevojshëm në secilin shtet dhe në secilin rajon qoftë aty ka investime për to ose jo, vetë drejtuesit e shkollave dhe arsimit duhet të kenë një ndërgjegje që të japin sa më tepër nga ajo që dinë dhe të përshtaten me ndryshimet që shohin

¹ Dr. Kit Prenton, Snezhana Jankulovska; përktheu: Zekerija Ibrahimi, “Mësimdhënia dhe mësimi në shekullin 21”, SH.A. Shtypshkronja “Napredok”-Tetovë, Shkup, 2009, fq. 12.

në shtetet më të përparuara, sigurisht duke ia përshtatur rajonit në të cilin gjendemi dhe mundësitë që kemi. Në kushte të përshpejtimit të ndryshimeve të brendshme të përbajtjes dhe organizimit të shkollave fillore me qëllim të përmirësimit të cilësisë së arsimit paraqitet nevoja që gjendjet me arsimin inicial të arsimtarëve dhe trajnimi plotësues i tyre të jenë vazhdimesht të përcjellura dhe të vlerësuara.

Numri më i madh i arsimtarëve në shkollat fillore kanë studime dyvjeçare për arsimtarët e akademisë pedagogjike, të grupeve të veçanta studimore për mësimin klasor dhe lëndor, kurse në praktikën mësimore arsimi i vazhdueshëm inicial i lëndëve për arsimtarë lëndor shpeshherë ju mundëson, kurse për disa raste edhe në lëndët tjera nga përbajtja gjuhësore. Ky proces është i mbështetur në ligjet sistemore, si dhe me ndyshimet e planeve dhe programeve mësimore në fakultetet për profesionin e arsimtarëve.²

Duke i pasur parasysh ndryshimet në arsimin fillor të detyrueshëm paraqitet nevoja që të përgatiten programe për trajnimin e arsimtarëve. Për përsosjen e arsimtarëve ekziston rregullativë ligjore sipas së cilës institucionale kompetente në këtë sferë janë: byroja e zhvillimit të arsimit, institucionet e larta arsimore, ku përgatiten arsimtarët, shkollat fillore, edukatorët dhe bashkëpunëtorët profesional.³

Këtë çështje të trajnimit të arsimtarëve do ta shqyrtojmë më shtruar edhe në një kapitull tjetër duke dhënë shembuj të projekteve që ka sjellur Ministria për trajnimin e tyre, pasi me vetë reformat apo më mirë thënë me risitë në arsim, duhet të vijnë edhe projekte reformuese për gjithë kuadratin e shkollës duke filluar nga drejtuesit e shkollës, ambientet, mjetet, si dhe mësimdhënësit dhe nxënësit.

Duke filluar t'i shmangemi mësimdhënies tradicionale u krijuan mësimdhënës me pikëpamje më premtuese dhe kualitative si dhe përmirësim në tërë procesin arsimor, sigurisht duke mos i anashkaluar këshillat e tradicionales pasi po të mos ishte ajo nuk do të arrinim këtu ku jemi sot dhe s'do mundeshim të përparojmë pa mos dëgjuar dhe mos u kthyer te kokat e ditura që na kanë lënë dëshmi të mençurisë.

² Vesna Horvatoviq, përkthyes: Mivedete Mahmuti; “Koncepti për edukim dhe arsimim fillor nëntëvjeçar”, Byroja e zhvillimit të arsimit, Shkup, 2007, fq. 43.

³ Vesna Horvatoviq, përkthyes: Mivedete Mahmuti; “Koncepti për edukim dhe arsimim fillor nëntëvjeçar”, Byroja e zhvillimit të arsimit, Shkup, 2007, fq. 46.

Ndryshimet që ndodhin në sistemin tonë arsimor

Decentralizimi i udhëheqjes në arsim - Decentralizimi synon që qytetarët, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të përfshihen më shumë në procesin e vendimmarjes në një numër më të madh të fushave, si: arsimi, planifikimi urban dhe rural, shëndetësia, kultura dhe zhvillimi lokal ekonomik. Pas miratimit të Ligjit të vetëqeverisjes lokale në vitin 2002, Republika e Maqedonisë e filloi këtë proces të sfidave të transferit të përgjegjësive nga niveli nacional në atë lokal/komunal.

Kështu duke filluar nga data 1 korrik 2005, edhe arsimi i mesëm edhe ai fillor u vunë nën juridikSION komunal. Ky transfer, ndër të tjera, nënkupton që komunat e kanë marrë përsipër pronësinë mbi godinat shkollore dhe pronat e tjera në lidhje me arsimin fillor dhe të mesëm, si dhe përgjegjësitë e mirëmbajtjes së godinave shkollore dhe pagesën e rrogave për ndihmësit profesionalë. Me zhvillimin e mëtejmë të procesit, komunat do të marrin përsipër edhe përgjegjësi plotësuese.⁴

➤ Planifikimi në arsim lëviz drejt ndryshimeve sistematike përmes përdorimit të EMIS dhe planifikimit vjetor në nivel të shkollës.

➤ Plani dhe programi mësimor ndryshojnë në pajtim me nevojat e Maqedonisë

Planprogramet mësimore (kurikulumi) paraqesin një grup të lidhur në mënyrë të ndërsjelltë të planeve dhe përvojave që nxënësi i realizon nën udhëheqjen e shkollës. (Marsh, 1997).⁵

Planprogramet mësimore (kurikulumi) paraqesin shumë të përgjithshme të përvojave që nxënësi i fiton si rezultat i kushteve të siguruara për shkollim. (Kelly, 1999).⁶

➤ Kompjuterizimi ofron mundësi dhe sfida të reja e interesante për mësim.

⁴ <http://www.osce.org/sq/skopje/19361?download=true>

⁵ Dr. Tomas Gerard Shiel, Dr. Damian Paul Murchan, Mr. Kiro Poposki, Mr. Gorica Mickovska; përktheu: Zeqirija Ibrahim; Qendra maqedonase për edukim qytetar, Akademia për zhvillim të arsimit, “Zbatimi i standardeve të notimit të nxënësve”, Shkup, 2008, fq. 21.

⁶ Dr. Tomas Gerard Shiel, Dr. Damian Paul Murchan, Mr. Kiro Poposki, Mr. Gorica Mickovska; përktheu: Zeqirija Ibrahim; Qendra maqedonase për edukim qytetar, Akademia për zhvillim të arsimit, “Zbatimi i standardeve të notimit të nxënësve”, Shkup, 2008, fq. 22.

Krahasimi ndërmjet sistemit të vjetër dhe sistemit të ri të arsimit

Fillimi i shkollimit - Në shkollë fillore regjistrohen të gjithë fëmijët që do të mbushin 6 vjet deri në fund të vitit kalendarik të regjistrimit në shkollë. Gjatë regjistrimit të fëmijëve në klasë të I -rë nuk bëhet përgjedhje, kurse shërbimi profesional, komisioni i cili bën regjistrimin e fëmijëve i përbërë nga pedagogu, psikologu dhe arsimtari për edukim parashkollar ose për mësim klasor. Anëtarët e komisionit mbajnë shënimë për të dhënat më të rëndësishme të marra nga prindërit dhe nga biseda me fëmijët. Këto informata shërbejnë në punën e mëtejshme me fëmijët në shkollë.⁷

Kjo mënyrë e pranimit të nxënësve në shkolla fillore është që moti, së pari prej kur fillon viti i ri në janar dërgohen thirrjet për paraqitjen e nxënësve që kanë mbushur 6 vjet ose do t'i mbushin gjatë muajve në vijim deri sa të fillojë viti i ri shkollor në shtator, pastaj bëhet regjistrimi i nxënësve nga personat në fjalë, pra njerëzit kompetentë në shkollë.

Plani për mësim në vitin shkollor - Në një vit shkollor sipas konceptit të ri, mësimi në shkolla fillore zgjat 38 javë, gjegjësisht 180 ditë pune shkollore. Sipas rregullës, mësimi është i organizuar pesë ditë në javë, ndërsa për t'i plotësuar ditët e punës shkollore është e nevojshme për ditët plotësuse.⁸ Me anë të kësaj paraqitet pjesëmarrja e të dy palëve që të jenë prezent në mësim për të funksionuar mësimdhënia dhe shkolla, domethënë nxënësit dhe arsimtarët. Është e domosdoshme që të zhvillohen procedura dhe metoda për vetëvlerësim të shkollës në tërësi, gjatë së cilës në bazë të kriterieve relevante duhet të vlerësohet programi vjetor për punën e shkollës.

Nxënësit prej klasës së I -rë deri të VI -të sipas rregullës nuk përsëriten në klasën e njëjtë dhe në kalimin prej klasës së VI -të deri të VII -të. Kështu nxënësi i cili nuk do të arrijë standarde caktuara nuk mbetet në klasë të njëjtë, megjithatë në vitin e ardhshëm shkollor në klasën e VII -të përmes mësimit të organizuar plotësues duhet të ketë mundësi që ta plotësojë njohurinë dhe t'i arrijë rezultatet e pritura.⁹

⁷ Vesna Horvatoviq, përkthyes: Mivedete Mahmuti; “Koncepti për edukim dhe arsimim fillor nëntëvjeçar”, Byroja e zhvillimit të arsimit, Shkup, 2007, fq. 73.

⁸ Vesna Horvatoviq, përkthyes: Mivedete Mahmuti; “Koncepti për edukim dhe arsimim fillor nëntëvjeçar”, Byroja e zhvillimit të arsimit, Shkup, 2007, fq. 77.

⁹ Vesna Horvatoviq, përkthyes: Mivedete Mahmuti; “Koncepti për edukim dhe arsimim fillor nëntëvjeçar”, Byroja e zhvillimit të arsimit, Shkup, 2007, fq. 95.

Këto kritere janë bazë për zhvillimin e drejtë të sistemit arsimor në një shkollë. Në një vend ku nuk ka rregulla nuk mund të kemi pritshmëri sepse secili do të veprojë në bazë të logjikës së vet, e cila do t'i duket si më e mira sepse secilit vetvetja i duket më e mirë, prandaj edhe në një institucion siç është shkolla duhet medoemos të ekzistojnë rregulla në pajtueshmëri me ligjet dhe kërkesat shtetërore, poashtu edhe respektues të po atyre rregullave.

Vetëm me anë të një organizimi të mirë dhe të një marrëveshjeje objektive do të arrihej një rezultat i duhur, gjë për të cilën na dëshmojnë një numër i konsiderueshëm shkollash të cilat janë shembuj të koordinimit me sukses të menaxhimit të tyre, si dhe krenari për gjenerata të nxjerra nxënësish, mësimdhënësish dhe drejtues të shkollave. Hulumtimet tregojnë se mësimi tradicional nuk është i përshtatur ndaj mënyrës se si mëson më së miri truri i njeriut.

Kjo flet për nevojën e zbatimit të metodave mësimore që u ndihmojnë nxënësve të mësojnë më mirë dhe të jenë më të shëndoshë, të jenë nxënës të lumtur dhe të mësojnë sikur mësojnë për gjithë jetën. Është e njohur se truri i njeriut në të njëjtën kohë përpunon pjesë dhe tërësi, se ne jemi të motivuar t'u japim kuptim gjérave që i mësojmë, se hulumtimi për kuptimin paraqitet me vendosjen e strukturës dhe është nën ndikim të thellë të emocioneve, se ekzistojnë mënyra të ndryshme të memorimit, se truri i njeriut ështëunik.

Kur është i angazhuar në mënyrë të plotë, atëherë nxënësit mësojnë më shumë se kur mësimi thjeshtësohet vetëm në memorim të fakteve. Ata përvetësojnë dituri që është dinamike – lloj i diturisë që në mënyrë natyrore dhe spontane u reflektohet ndërveprimet autentike në botën reale.¹⁰ Nga kjo pjesë e marrë nga libri në fjalë është dhënë shumë qartë ideja se përsë duhej të krijohej një mënyrë e re e mësimdhënies duke ndryshuar nga ajo tradicionalja. Kjo me një fjalë quhet konstruktivizëm.

Nga vet fakti që çdo gjë e cila përsëritet bëhet banale, domethënë rutinë, atëherë u pa nevoja që edhe në arsim të ketë mënyra të reja të shpjegimit të njësive, me të vetmin qëllim që të ketë efikasitet më të lartë dhe se sa më lehtë ta kenë nxënësit memorimin e të dhënavë apo informatave që do t'i marrin çdo ditë në shkollë. U përdorën metoda të ndryshme duke e bërë mënyrën e shpjegimit të njësive mësimore sa më tërheqëse dhe sa më të lehtë për ta mbajtur mend. Ky lloj ndryshimi në sistemin arsimor solli edhe seminare të ndryshme të mbajtura nga Ministria e arsimit dhe shkencës në shtetin tonë, ku duke përfshirë tema të ndryshme dhe projekte të finansuara si nga shteti, poashtu edhe nga shtete të huaja, mësimdhënësit u trajnuan që ta kenë sa më të lehtë bartjen e kësaj bare dhe këtij ndryshimi.

¹⁰ Dr. Kit Prenton, Snezhana Jankulovska; përktheu: Zekerija Ibrahim, “Mësimdhënia dhe mësimi në shekullin 21”, SH.A. Shtypshkronja “Napredok”-Tetovë, Shkup, 2009, fq. 12.

Ky kalim nga mësimi tradicional në atë të sotëm sigurisht së pari është marrë me një drojtje, por kur duke praktikuar ide të dhëna në ato seminare të mbajtura, kanë parë që edhe për mësimdhënësit është shumë e lehtë shpjegimi me sukses i një njësie me anë të këtyre metodave se sa ka qenë më përpara. Këto projekte arrijnë që nxënësit ta presin me shumë dëshirë orën se kur do të shkojnë në shkollë, pasi në ato orë që do të kalojë në shkollë me anë të lojërave mësimore që do t'i japë arsimtari, do t'i duket sa atraktive dhe e shoqërueshme, po aq efektive edhe në mbamendjen e përkufizimeve dhe qëllimit që ka dashur mësimdhënësi të arrijë në atë orë mësimore.

Çka tregon përvaja jonë

Në periudhën pas vitit 1996 ka pasur bashkëpunim në mes nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve në shkollat fillore në vendin tonë që të përshpejtohet dhe të pasurohet. Në mbledhjet me arsimtarët e klasave dhe kujdestarin e klasës në mësim lëndor prindërit të kenë marrëveshje dhe t'i planifikojnë aktivitetet me të cilat do të përmirësohen kushtet për punë edukativo – arsimore. Me ligjin por gjithashtu edhe me praktikë nuk janë treguar kompetencat e këshillit të prindërve në shkollë. Për këtë arsyе është lënë pas dore ndikimi i tyre në organizimin e jetës dhe punës së nxënësve dhe arsimtarëve në shkollë.¹¹

E shohim shumë qartë që thuhet se bashkëpunim ndërmjet trekëndëshit mësues – nxënës – prind, është dashur të ketë edhe atë që nga vitet e 90-të, por se sa është praktikuar kjo nëpër shkolla flasin pakënaqësitë e të tre palëve. Në vitet e fundit shihet një lloj ndryshimi lidhur me këtë pasi në secilën shkollë dhe secilin vit shkollor përzgjidhet një përfaqësues i prindërve të nxënësve në shkollë, pasi është shumë më mirë kur për çështje që janë tepër serioze të ketë me kë duhet të ndërmjetësojë mësimdhënësi.

Rezultatet nga analiza dhe hulumtime tjera relevante

Nxënësit shumë pak marrin pjesë në vendosjen e punëve që kanë të bëjnë me jetën shkollore, nuk kanë mundësi që t'i marrin informacionet relevante, e as ta tregojnë mendimin e tyre që të ndikojnë në bazë të vendimeve që aplikohen në shkollë. Raporti i arsimtarëve mund të përshkruhet si mbrojtës/nënçmues dhe nuk e nxit zhvillimin e nevojës për pjesëmarrje të nxënësve, e as që u siguron nxënësve vegla me të cilat do të mund të zgjedhen për përbushjen e nevojave dhe interesave të tyre.

¹¹ Vesna Horvatoviq, përkthyes: Mivedete Mahmuti; “Koncepti për edukim dhe arsimim fillor nëntëvjeçar”, Byroja e zhvillimit të arsimit, Shkup, 2007, fq. 49.

Konventa pér të drejtat e fëmijëve nuk është shpërndarë gjerësisht te fëmijët, ndërsa arsimtarët kanë njohuri të pakta të vlerave të cilat promovohen me atë dhe kanë rezistencë ndaj implementimit të Konventës në praktikë.¹² Pjesëmarrja e nxënësve në procesin arsimor nga ajo që u tha më lartë shohim që është shumë e cekët apo më mirë të themi që aspak nuk pyeten rreth vendosjes së ndonjë detyre shkollore në të cilën ato janë komponenta më kryesore dhe se do të jenë po ato që u bie ngarkesa pér t'i kryer po të njëjtat detyra.

Bibliografia

- HORVATOVIQ, Vesna (2007). *Koncepti pér edukim dhe arsimim fillor nëntëvjeçar*, Shkup: Byroja e zhvillimit të arsimit.
- PRENTON, Kit & JANKULLOVSKA Snezhana (2009). *Mësimdhënia dhe mësimi në shekullin 21*, Shkup: Napredok.
- SHIEL, Tomas Gerard & MURCHAN, Damian Paul & POPOSKI, Kiro & MICKOVSKA, Gorica (2008). *Zbatimi i standardeve të notimit të nxënësve*, Shkup: Qendra maqedonase pér edukim qytetar, Akademia pér zhvillim të arsimit.

¹² Vesna Horvatoviq, përkthyes: Mivedete Mahmuti; “Koncepti pér edukim dhe arsimim fillor nëntëvjeçar”, Byroja e zhvillimit të arsimit, Shkup, 2007, fq. 52.